

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatorin Ekonomik: KOMPANIA E SIGURIMEVE EUROSIG SH.A., 2 Korriku nr. 4, 10000, PRISHTINË Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	29.11.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **27.11.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **KOMPANIA E SIGURIMEVE EUROSIG SH.A.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **SIGURIMI I AUTOMJETEVE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-23-10697-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-067-2-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **KOMPANIA E SIGURIMEVE EUROSIG SH.A.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **SIGURIMI I AUTOMJETEVE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-23-10697-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-067-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **21.11.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II.** Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit, me Numër të prokurimit: **623-23-10697-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-067-2-2-1**
- III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **KOMPANIA E SIGURIMEVE EUROSIG SH.A.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **SIGURIMI I AUTOMJETEVE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-23-10697-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-067-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **21.11.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **27.11.2023**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMET E TUA ANKIMORE:

Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku kemi cekur:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ne Nëndegën e Kompanisë së Sigurimeve EUROSIG SH.A., në Rahovec, Ndërmjetësi i sigurimeve është Znj. Besmire Bytyqi, ku në Komunën e Rahovecit, e Njëjta ka pozitën si Drejtoresha për Drejtorin e Mbrojtës dhe Shpëtim, (ku nga CV-ja e publikuar ne webfaqe te Komunës, që është ende prezent ne këtë Kompani, sipas linkut: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2018/04/Besa-Bytyci-CV.pdf>)

Duke u bazuar ne **Ligjin Nr. 06/L-011 PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TE INTERESIT NË USHTRIMIN E FUNKSIONI PUBLIK** përkatësisht **Nenit 12 dhe Nenit 13 të këtij Ligji**, oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës se Prokurimit
Komuna e Rahovecit